



# EB

## Rrugë për prindërit (Wege für Eltern)

Shqetësoheni për zhvillimin e fëmijës suaj? A nuk mund të gëzohet më vërtet fëmija juaj? A ka ngarkesa në familje? A ka fëmija juaj probleme në shkollë? Ne jemi të gatshëm për ju.

Grindje, kokëfortësi, mosbindje, frikë ose probleme shkollore e ngarkojnë jetën e familjes dhe i futin prindërit në pasiguri. Ndoshta ka në familjen tuaj një ndarje ose një situatë tjetër të vështirë për fëmijën tuaj. Tema të tilla njohin shumë familje. Ne ju mbështetim.

### Kështu bashkëpunojmë ne

Në bisedën e parë ne i sqarojmë me ju dëshirat tuaja. Lidhur me këtë ne interesohemi për përvojat, shqetësimet tuaja si dhe për idetë tuaja për zgjidhjet. Ndoshta ne do të flasim edhe vetëm me fëmijën tuaj. Pastaj ne bisedojmë së bashku për rrugë të mundshme të zgjidhjeve. Në situata të vështira ne ju shoqërojmë ju ose fëmijën tuaj edhe me një afat më të gjatë me këshillimose mbështetje psikoterapeutike. Nëse është e nevojshme ne konsultohemi, me pëlqimin tuaj, me specialistë të tjerë. Në rast të problemeve shkollore në bisedë me ju dhe me forcat mësimorene mund të marrim masa shkollore për fëmijën tuaj.

### Këtë mund ta besoni

Këshillimorja për edukim e kantonit Bernë (EB) është një këshillimore e pavarur. Psikologët tona dhe psikologët tanë kanë një diplomë universitare në psikologji dhe një kualifikim shtesë në psikologji shkollore dhe këshillim për edukim, shpesh herë edhe një kualifikim për terapi. Ata i nënshtroheni detyrimit të mbajtjes sekret. Shërbimet për familje, të rinj dhe shkolla janë falas. Kompetente është EB që nga lindja deri në përfundimin e kualifikimit profesional bazë dhe të mesëm.

### Na merrni në telefon

Prindër dhe të rinj mund të regjistrohen nëpërmjet telefonit tek zyra rajonale në afërsinë e tyre. Në rast të vështirësive shkollore bisedoni për situatën, ju lutemi, fillimisht me forcën mësimore. Ajo, me pëlqimin tuaj, do ta regjistrojë fëmijën tuaj me shkrim. Nëse një bisedë në gjuhën gjermane është e vështirë për ju, ne gëzohemi nëse ju sillni dike me vete që ndihmon gjatë përkthimit. Nëse kjo nuk është e mundshme, ne mund të që përkthen.

### Të gjesh rrugë

Këshillimorja për edukim është një shërbim i drejtorisë për edukim të kantonit Bernë  
[www.be.ch/erziehungsberatung](http://www.be.ch/erziehungsberatung)